

**LIGJ**  
**Nr.8408, datë 25.9.1998**

**PËR POLICINË E NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Policia e ndërtimit është organ ekzekutiv, i armatosur, i specializuar për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën e punimeve të ndërtimit dhe të urbanistikës.

**Neni 2**

Policia e ndërtimit varet nga Ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit. Ajo përbëhet nga drejtoria e policisë së ndërtimit dhe degët e saj, të cilat zbatojnë detyrat e caktuara me ligj dhe me vendimet e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të këshillit të rregullimit të territorit në rrethe e bashki.

**Neni 3**

Policia e ndërtimit ka këto kompetenca:

1. Të kontrollojë dhe të zbatojë dispozitat ligjore në fushën e urbanistikës dhe të punimeve të ndërtimit.
2. Të vendosë gjoba për shkeljen e dispozitave ligjore të mësipërme. Një pjesë e të ardhurave të krijuara prej tyre i kalojnë policisë së ndërtimit.
3. Të pezullojë e të marrë vendim për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm.

**Neni 4**

Policia e ndërtimit pezullon punimet e ndërtimit të objekteve, kur vëren shkelje të kushteve teknike të projektimit dhe të kushteve teknike të zbatimit nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj dhe i propozon zyrës së licencave pranë Ministrisë përkatëse heqjen e licencës së drejtuesve teknikë të tyre.

Kur kërkohet nga institucionet e prokurorisë apo nga institucionet e interesuara, subjektet ndërtimore, që konkurrojnë në procedura tenderimi, janë të detyruara të marrin një vërtetim zyrtar vlerësimi nga organet e policisë së ndërtimit.

**Neni 5**

Policia e ndërtimit, në zbatim të kushteve të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" dhe të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", kontrollon dhe merr masat e duhura për pezullimin e punimeve, prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe jep dënimin me gjobë.

**Neni 6**

Policia e ndërtimit pezullon e njofton Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së

Shqipërisë për vendimet e marra nga këshilli i rregullimit të territorit të rrethit ose i bashkisë, kur vëren shkelje të ligjit në vendimet e tyre.

#### Neni 7

Policia e ndërtimit, për kryerjen e detyrave të veta, bashkëpunon me organet e pushtetit lokal, prefekturat dhe policinë e rendit e atë bashkiake. Bashkëpunimi realizohet sipas akteve nënligjore përkatëse.

#### Neni 8

Oficerë dhe agjentë të policisë së ndërtimit, të caktuar nga ministri që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit, ushtrojnë funksionet e policisë gjyqësore.

#### Neni 9

Policia e ndërtimit ka uniformën, pajisjet, makineritë dhe grupet speciale të prishjes së ndërtimeve të kundërligjshme, që përcaktohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Punonjësit e policisë së ndërtimit, që do të pajisen me armë zjarri dhe pajisje speciale, përcaktohen nga ministri që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit në bashkëpunim me ministrin e Rendit Publik.

#### Neni 10

Në shërbimin e policisë së ndërtimit pranohen shtetasit që plotësojnë këto kërkesa:

- të jenë shtetas shqiptarë;
- të kenë kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak ose të kenë shërbyer në Forcat e Armatosura;
- të kenë, të paktën, arsimin e mesëm profesional kryesisht për ndërtim;
- të mos jenë dënuar për vepra penale;
- të jenë të aftë nga ana fizike.

#### Neni 11

Këshilli i Ministrave miraton strukturën e policisë së ndërtimit dhe statusin e saj.

#### Neni 12

Ligji nr.7752, datë 28.9.1993 "Për policinë e ndërtimit" dhe të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

#### Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2227, datë 5.10.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**